



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:188010

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06442373

KA.nr.539/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “The Golden Sill” me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Sylejman Klinaku nga Prishtina, kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Besim Zllashi, nga avokatura shtetërore për shkak të anulimit të vendimit AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 14.10.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës paditëse dhe të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 23.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësi “The Golden Sill” me seli në Prishtinë kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Prishtinë, me çka ka kërkuar të anulohet vendimi i Komisionit të Ankesave të së paditurës AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, me propozim që të detyrohet e paditura në rimbursimin e shumës prej 2,000.00 euro me kamat ligjore prej 8 % nga dita e pagesës deri në pagesën definitive, **si e pa bazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 30.12.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “The Golden Sill” me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2277/2020, kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (më tutje referuar AUV) me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa vendimi i të paditurës me nr. AUV.Ref.04/2-2397/2020 i datës 15.12.2020 të anulohet dhe të detyrohet i padituri që të rimbursoj shumën e gjobitur prej 2,000.00 euro dhe atë në kamat ligjore prej 8 % nga dita e pagesës deri në pagesën definitive.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 539/22.
3. Gjykata më datë 14.10.2024 mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Sylejman Klinaku, sipas autorizimit të datës 27.12.2020 dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditurit avokat Z.Besim Zllashi, nga avokatura shtetërore sipas autorizimit të datës 14.10.2024.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit përmes pretendimeve të dhëna përmes padisë, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e paditura në vendimin e kundërshtuar me padi nuk e a bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike., pasi që e njëjta vetëm është bazuar në vendimin e Inspektoratit Sanitar me rastin e shqiptimit të gjobës dhe jo edhe në të dhënat, konkretisht provat e paraqitura nga paditësi, pasi që nuk qëndron fakti se Inspektorati Sanitar ka gjetur klient brenda lokalit të paditësit, pasi që paditësi objektin e ka pasur të mbyllur duke i respektuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat anti covid.

5. Sipas tij, Inspektorati ka tejkalluar masën e shqiptimit të gjobës në kundërshtim me nenin 56 të Ligjit për Kundërvajtje, pasi që lokali në ditën e ardhjes së Inspektorëve nuk ka qenë i hapur në shërbim ndaj klientëve. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa vendimi i të paditurës me nr. AUV.Ref.04/2-2397/2020 i datës 15.12.2020 të anulohet dhe të detyrohet i padituri që të rimbursoj shumë e gjobitur prej 2000 eurove dhe atë në kamat ligjore prej 8 % nga dita e pagesës deri në pagesën definitive.

Kundërshtimet e palës së paditur

6. I padituri në deklaratimet e dhëna përmes përgjigjen në padi, si dhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kundërshtojmë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit pasi që konsiderojnë se vendimi i palës së paditur i shkallës së parë dhe vendimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave i datës 15.12.2020 janë vendime të drejta dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi. Pala paditëse në këtë rast “Restaurant Golden Sill” konkretisht pronari i saj duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.07/L-006, konkretisht neni 25 dhe në kundërshtim me vendimin nr.01/42 të datës 11.11.2020 të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës i njëjti ka vepruar në kundërshtim me masat e përcaktuara gjatë periudhës së pandemisë.
7. Duke vepruar kështu tani paditësi edhe pse ka qenë e ndaluar që në restaurant të shërbehen klientë në ora 21:44 minuta, inspektorët gjatë vizitës në restaurantin Golden Sill kanë hasur në 8 klientë të cilët kanë qenë prezent në këtë hapësirë respektivisht të ulur në tavolinë të cilët kanë qenë duke u shërbyer në orën 21:44.
8. Referimit të palës paditëse të paraqitura në ankesën e parashtruar në komisionin e ankesave dhe në padi nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova, për arsye se e i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme materiale që do të dëshmonin pretendimet e tij. Mbi bazën e kësaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të mbeten në fuqi vendimet e të paditurës si të bazuara në ligj.

Provat e administruara

9. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi nr.AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, Fletë përmbajtje për kundërvajtje me nr. serik. 017168, Ankesë e paditësit dorëzuar tek e paditura me datë 08.11.2020 për rishqyrtim të gjobës, Vendim me numër 01/42 me datë 11.11.2020.
10. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.
11. Qeveria e Republikës së Kosovës përmes vendimit me numër 01/42 me datë 11.11.2020 në pikën 25. 1 të këtij vendimi ka ndaluar lëvizjen e qytetarëve të Kosovës jashtë shtëpive/banesave ët tyre pas orës 19:00 e deri ën orën 05:00, përveç për nevoja emergjente dhe shëndetësore, ndërsa në pikën 25.3 ka ndaluar veprimtarinë e gastronomisë nga ora 19:00 deri në orën 05:00.
12. Nga Fletë përmbajtjeapër kundërvajtje me nr. serik. 017168, e datës 05.12.2020, ora 21:44 minuta Inspektorati Sanitar i Kosovës i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 2,000.00 euro personit juridik tani paditës “The Golden Sill” SH.P.K., me prona E.B., për shkak se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 par. 1 të Ligjit nr. nr. 07 /L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19, dhe nuk ka respektuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/42 të datës 11.11.2020, përmes të cilit është ndaluar lëvizja pasi që subjekti juridik i lartcekur ka pasur 8 klient në tavolina të lokalit dhe ka qenë duke shërbyes në ora 21:44 min.
13. Paditësi me datë 08.12.2020 ka parashtruar ankesë të dorëzuar te e paditura për rishqyrtim të gjobës së shqiptuar nga Inspektorati Sanitar i Kosovës përmes Fletë përmbajtjes për kundërvajtje me nr. serik. 017168.
14. Nga Vendimi nr.AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në AUV-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, e ka refuzuar ankesën me nr. 7577 të datës 08.12.2020, në arsyetimin e të cilit vendim janë

paraqitur faktet si në vijim: Inspektorati Sanitar më datë 05.12.2020 në ora 21:44 pas inspektimit të “The Golden Sill” SH.P.K., me seli në Prishtinë kanë konstatuar se personi juridik nuk ka respektuar Ligjin Nr. 07/L-006, respektivisht nenin 25 të këtij ligji dhe Vendimin me nr. 01/42 të datës 11.11.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 25 dhe 25.1 në të cilin vendim është kufizuar lëvizja e lirë, pasi që subjekti i lartcekur ka pasuar 8 klientë në tavolina dhe i njëjti ka qenë duke i shërbyer klientët në ora 21:44, dhe pas këtyre të gjeturave nga Inspektorati Sanitar i është shqiptuar gjoja në shumën prej 2,000.00 euro në bazë të nenit 25.1 të Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19. Vetë kryesi i kundërvajtjes ka pranuar se ka qenë i vetëdijshëm se përmes Vendimit nr. 01/42 të datës 11.11.2020 gastronomia ka qenë e ndaluar pas orës 19:00, por i njëjti pasi që ka shërbyer në ora 21:44 ka qenë i vetëdijshëm për veprimin e tij, andaj me dashje ka shkelur pikën 25 në pikën 25.3 të vendimit të Qeverisë nr. 01/42 të datës 11.11.2020, dhe nenin 25 par. 1 të Ligjit nr. 07 /L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid 19. Po ashtu nuk qëndron pretendimi se darkat private janë të lejuara pasi që si pretendim është i pa bazuar dhe në kundërshtim me Ligjit nr. 07 /L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid 19.

Vlerësimi i gjykatës

15. Gjykata vlerësoj se padia është parashtruar, sipas Nenit 13 paragrafi 1, të LKA ku përcaktohet se Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën, administrative në shkallë të dytë.
16. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
17. Vendimi i Organit të Shkallës së Dytë i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë AUV.Ref.04/2-2397/2020 i datës 15.12.2020 është në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 07/1-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, Neni 1 përcakton se “Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore

për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19”. Neni 25 përcakton aktivitetet e caktuara në mjedise private dhe publike, paragrafi 1 parasheh se *“personi juridik që organizon aktivitete të ndaluara me vendim të Organit Kompetent dënohen me gjobë prej dy mijë (2000) euro dhe ndalimin e aktivitetit, ndërkaq personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë me dymijë (2000) euro”*.

18. Ndërsa, në vendimin e Qeverisë me nr. 01/42 i datës 11.11.2020 në pikën 25. 1 është ndaluar lëvizja e qytetarëve të Kosovës jashtë shtëpive/banesave ët tyre pas orës 19:00 e deri në orën 05:00, përveç për nevoja emergjente dhe shëndetësore, ndërsa në pikën 25.3 është ndaluar veprimtaria e gastronomisë nga ora 19:00 deri në orën 05:00.
19. Nga provat e administruara nuk u konstatua me asnjë provë se paditësi kishte respektuar masat mbrojtëse kundër Covid 19, të cilat ishin në fuqi dhe të zbatueshme në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar dhe se i njëjti të ketë respektuar vendimin me nr. 01/42 i datës 11.11.2020, pasi që Inspektorët në momentin e inspektimit kanë konstatuar që pronari dhe punëtorët e paditësit janë gjetur duke shërbyer në restaurant 8 klientë në tavolina duke u shërbyer klientëve në ora 21:44 min. Sipas nenit 25 par.1 Neni 25 përcakton aktivitetet e caktuara në mjedise private dhe publike paragrafi 1 parasheh se *“personi juridik që organizon aktivitete të ndaluara me vendim të Organit Kompetent dënohen me gjobë prej dy mijë (2000) euro dhe ndalimin e aktivitetit, ndërkaq personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë me dymijë (2000) euro*.
20. Bazuar në dispozitat e lartcekura paditësi ‘Golden Sill’ SH.P.K., si person juridik e ka pasur të ndaluar të ushroj aktivitetin e gastronomisë dhe të qarkulloj pas orarit të lejuar. Andaj, Gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri e ka vërtetur në procedurë administrative. Prandaj, vlerëson se e paditura Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me Vendimi AUV.Ref.04/2-2397/2020 të datës 15.12.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative si dhe ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar.
21. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative,

gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.539/22, datë 23.10.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.